



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/30/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga F.B ndaj gjyqtarit N.Q, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 12.12.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga F.B ndaj gjyqtarit N.Q për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Ankuesi F.B me datë 21.11.2024 drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit N.Q me pretendimet për shkelje disiplinore gjatë trajtimit të lëndës C.nr.2316/24, rrjedhimisht edhe me pretendimet për dërgim jo të rregullt të këtij aktgjykimi, ku sipas tij zarfi i dërguar i cili përmbante aktgjykimin nuk ishte zarf zyrtar por privat pasi që sipas tij është telefonuar rreth orës 19:08 jashtë orarit zyrtar të punës nga një numër privat i cili i ka thënë se është një zarf nga Gjykata Themelore në Prishtinë, pranimin e të cilit duhet ta nënshkruani. Sipas tij i njëjti është përgjigjur se nuk nënshkruan zarf privat dhe jo një zarf zyrtar nga Gjykata Themelore, duke pretenduar se dërgimi i këtij zarfi është bërë në kundërshtim me shkresat dhe udhëzimet ligjore nën dyshimet që është kryer një veprë penale ndaj këtij zarfi. Tutje ka deklaruar se brenda në këtë zarf ka qenë Aktgjykimi C.nr.2316/24 i cili ka qenë i shlyer dhe i pakuptueshëm. Po ashtu, ka deklaruar se kërkon nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata e Apelit që të fillojnë hetimet ndaj këtij Aktgjykimi të lëshuar pasi që janë shkelur procedurat ligjore dhe nuk janë kërkuar deklaratat e avokatit, paditëses, QPS.

Me datë 25.11.2024 sipas kompetencës, ankesa disiplinore nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për trajtim dhe vendosje.

Gjyqtari i çështjes në lidhje me ankesën e parashtruar ka deklaruar se parashtruesi i ankesës është palë e paditur në procedurën kontestimore me numër C.nr.2316/24 me bazë juridike besimin e fëmijës, kontaktet dhe alimentacionin. Sipas gjyqtarit, gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me aktgjykimin e datës 07.05.2024 ka vendosur në mënyrë meritore lidhur me këtë çështje juridike. Bazuar në dispozitat e LPK-së, gjykata ka provuar disa herë përmes

shërbimit postar që të dorëzojë aktgjykimin te pala e paditur, megjithatë ky dorëzim nuk është realizuar.

Tutje ka deklaruar se meqenëse pala e paditur ka qenë e pranishme në seancat gjyqësore dhe për shkak se çështja ka të bëjë me të drejtën familjare, gjyqtari ka kërkuar nga shërbimi i dorëzimit të gjykatës që aktgjykimi të dorëzohet të paditurit personalisht. Për këtë qëllim, sipas tij shërbimit të dorëzimit i është ofruar edhe numri i telefonit të palës së paditur, në mënyrë që kontakti dhe dorëzimi të realizohen më lehtë.

Sipas tij, dorëzimi i kryer nuk përbën dorëzim privat, por një dorëzim zyrtar i kryer nga zyrtari i gjykatës, i autorizuar sipas dispozitës së nenit 103 par. 1 të LPK-së, si dhe nënshkrimi i pranimit të fërgesës është detyrim ligjor i paraparë me nenin 121 paragrafi 1 i LPK-së për të vërtetuar faktin se dërgesa i është dorëzuar personalisht marrësit. Ndërsa, në rast se marrësi refuzon të firmosë dëftesën e komunikimit, sipas nenit 121 par. 3 të LPK-së përcaktohet që një gjë e tillë konstatohet në dëftesën e komunikimit dhe do të shkruhet me shkronja data e dorëzimit dhe kështu konsiderohet se është kryer dorëzimi i rregullt.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit N.Q.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Nuk është kontestuese se në lëndën C.nr.2316/24 me datë 07.05.2024 është nxjerrë Aktgjykimi C.nr 2316/24, sipas të cilit është aprovuar në tërësi padia e paditëses A.D.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës është vërtetuar se në rastin konkret është tentuar dorëzimi i Aktgjykimit tek pala e paditur përmes postës disa herë, por që nuk ka arritur të realizohet.

Fakti se dorëzimi i Aktgjykimit është bërë nga ana e punonjësve të shërbimit postar brenda gjykatës, nuk nënkupton se është bërë shkelje e dispozitave ligjore sepse neni 103 i LPK-së shprehimisht parasheh se *“shkresat dërgohen nëpërmjet postës, por mund të dërgohen edhe nëpërmjet punëtorit të autorizuar të gjykatës, të personit juridik të regjistruar dhe autorizuar për kryerjen e punëve të komunikimit”*.

Ndërsa, po ashtu, në çdo rast kur marrësi refuzon të nënshkruajë fletë dërgesën si dëshmi të pranimit të Aktgjykimit, gjykata vepron sipas nenit 121 par. 3 të LPK-së i cili parasheh se *“po që se marrësi refuzon ta firmosë dëftesën e komunikimit, komunikuesi do ta konstatojë një gjë të tillë në dëftesën e komunikimit dhe do ta shkruajë me shkronja datën e dorëzimit dhe kështu konsiderohet se është kryer dorëzimi i rregullt”*.

Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se veprimet e gjyqtarit gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore, janë veprime të ndërmarra në kuadër të autorizimeve të tij si gjyqtar dhe si të tilla nuk mund të paraqiten si pretendime për shkelje disiplinore.

Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se pretendimet e parashtruara nga i njëjti mund të jenë pretendime për shkelje procedurale të cilat mund të atakohen me ankesë në Gjykatën e Apelit, pasi të merret vendimi përfundimtar në lidhje me çështjen gjyqësore. Gjykata e Apelit si shkallë e dytë është kompetente që të shqyrtoj sipas detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore a po nëse është shkelur ligji në dëm të ndonjëres palë.

Parashtruesi i ankesës në asnjë mënyrë dhe në asnjë provë nuk e ka argumentuar se gjyqtari ka ndërmarrë veprime që janë të parapara si shkelje disiplinore nga neni 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Andaj, autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari N.Q ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/30/24, me datë 12.12.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë